INSTITUTI
DEMOKRATIK
I KOSOVËS

SHQYRTIMI I PRAKTIKAVE TË LIGJIT PËR PARTITË POLITIKE

PRISHTINË, MARS 2017

ZGJEDHJET E LIRA
DHE TË DREJTA

COPYRIGHT © 2017. Kosova Democratic Institute (KDI).

Përgatitur nga: Albert Krasniqi

Me asistencë hulumtuese nga: Agnesa Haxhiu

Instituti Demokratik i Kosovës i ka të gjitha të drejtat të rezervuara dhe asnjë pjesë e këtij botimi nuk lejohet të riprodhohet ose të transmetohen në çfarëdo forme, mekanike apo elektronike, përfshirë fotokopjimin ose çdo sistem tjetër të ruajtjes dhe nxjerrjes së materialeve, pa lejen me shkrim të botuesit. Publikimi mund të riprodhohet ose të transmetohet vetëm nëse përdoret për qëllime jokomerciale. Kurdo dhe kushdo që përdor citate a materiale të ndryshme të këtij botimi, është i obliguar ta bëjë të qartë burimin nga do t'i ketë marrë ato citate ose materialeve që përdoren.

Për çdo vlerësim, vërejtje, kritikë apo sugjerim, luteni të na kontaktoni përmes mundësive të ofruara më poshtë:

Adresa: Rr. Bajram Kelmendi, Nr. 45,
10 000, Prishtinë, Kosovë.
Tel.: +381 (0)38 248 038
E-mail: info@kdi-kosova.org
Ueb: www.kdi-kosova.org

PËRMBAJTJA

I. Hyrje 4
II. Çka janë partitë politike 5
III. Çka është Ligji për Partitë Politike 6
Dallimi në mes të Ligjit për Partitë Politike, Ligjit për Zgjedhjet, Ligjit për Fushatat dhe atij për Financimin e Partive Politike 8
IV. Praktikat Ndërkombëtare për Ligjin për Partitë Politike 9
V. Modelet e ligjit për partitë politike 12
Modeli ndalues/dëbues 12
Modeli lejues 13
Modeli promovues 13
Modeli mbrojtës 14
Modeli përshkrues 14
VI. Çka duhet të përmbajë Ligji për Partitë Politike 15
Definicioni ligjor dhe statusi i partive politike 15
Regjistrimi dhe Statuti 17
Organizimi i brendshëm 17
Përzgjedhja e kandidatëve 18
Financimi i partive politike 20
Organizimi dhe sjelljet në parlament 21
Zbatimi i rregullave dhe zgjidhja e kontesteve 22
Sanksionet dhe ndalesat ndaj partive politike 23
VII. Përfundim 25
VIII. Referencat 27

I. HYRJE

Mënyra e funksionimit dhe organizmit të brendshëm të partive politike është njëri ndër faktorët kryesor që ndikon në sjelljen e institucioneve shtetërore dhe nivelin e zhvillimit të shtetit në përgjithësi. Sa më demokratike, transparente dhe gjithëpërfshirëse të jenë partitë politike, aq më i zhvilluar do të jetë niveli i demokracisë së atij vendi. Partitë në shumë shtete financohen pjesërisht apo tërësisht nga buxheti i shtetit. Ato i përfaqësojnë interesat e qytetarëve në Kuvend dhe qeverisin në emër të tyre kur ta marrin pushtetin. Prandaj është në rritje gjithnjë e më shumë nevoja për mbikëqyrje të partive politike, apo thënë më mirë, e vendosjes së disa rregullave ligjore që pengojnë qeverisjen autoritare të tyre.

Ky punim ofron një analizë të përgjithshme të praktikave të shteteve të ndryshme mbi rregullimin ligjor të funksionimit të partive politike. Qëllimi i këtij punimi është të trajtojë se çfarë përmban një ligj i tillë dhe se cilat janë modelet e njohura deri më tani. Punimi koncentrohet në disa çështje më të rëndësishme, si: rregullimi i brendshëm i partive, përzgjedhja e kandidatëve dhe zgjidhja e konflikteve të brendshme.

Punimi tenton t'i shërbejë diskutimeve më të gjera për të vlerësuar nevojën e inicimit të Ligjit për Partitë Politike, dhe mund të shfrytëzohet nga ligjvënësit apo studiuesit e partive politike.

Duke pasur parasysh faktin se Kosova nuk ka një legjislacion të veçantë që rregullon mënyrën e funksionimit të partive politike, problemet me menaxhimin dhe kontrollin e financave të partive politike dhe numrin në rritje të partive të reja, janë disa prej faktorëve që kanë nxitur nevojën për diskutimin e një ligji të tillë. Deri tani, aspekte të funksionimit të partive politike në Kosovë janë rregulluar përmes Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjit për Financimin e Subjekteve Politike, ligje këto që vetëm tërthorazi rregullojnë funksionimin ligjor të partive. Pjesa tjetër rregullohet

nëpërmjet legjislacionit sekondar, përkatësisht rregullave zgjedhore të KQZ-së. Këto rregulla kanë gjetur zbatim të pjesshëm në praktikë dhe kryesisht u janë imponuar partive politike më të vogla, të cilat nuk kanë pasur të drejtë për të propozuar anëtarë në KQZ. Arsye tjetër për mos respektim të plotë të këtyre rregullave ka qenë edhe mungesa e bazës ligjore për to, pasi që KQZ-ja, në raste të caktuara ka dalë përtej kornizës ligjore të paraparë.

Ky punim diskutues është i bazuar kryesisht në tri punime paraprake në këtë temë, të autorëve prominent, si: Lauri Karvonene -"*Legjislacioni për Partitë Politike: Një krahasim global*"; Kenneth Janda- "*Adaptimi i ligjit për partitë politike*"; si dhe Richard Katz - "*Reformimi i partive politike përmes rregullimit ligjor*". Për qëllime të kësaj analize janë shfrytëzuar edhe punime të tjera nga fusha e ligjit për partitë politike, por me theks në bazën e të dhënave të Universitetit "Leiden", *"Ligji për Partitë në Evropën Moderne: Rregullimi ligjor i partive politike në Evropën e pasluftës"*. Një bazë e veçantë e të dhënave është krijuar nga KDI-ja, për të gjitha vendet, të cilat kanë të miratuar ligje për partitë politike. Këto ligje më pastaj janë analizuar ndaras për të parë praktikat dhe modelet e rregullimit të partive politike përmes legjislacionit.

II. ÇKA JANË PARTITË POLITIKE

Në shtetet bashkëkohore është e vështirë të mendohet të jesh politik pa pasur parti politike. Në të vërtetë, në disa shtete, sot janë të ndaluara partitë politike. Kjo praktikë ekziston në shoqëritë tradicionale, veçanërisht në Gjirin Persik, ku disa shtete ende qeverisen nga familje me stazh të gjatë pushteti, mbase ende pa u njohur nga bota si shtete të pavarura. Në këto regjime partitë politike dhe aktivitetet e tyre janë të ndaluara. Këto regjime drejtohen ose nga ushtria, ose nga sundimtarë autoritar që kanë mbështetjen e ushtrisë.[1]

Partitë kanë filluar si formë e organizimit brenda shoqërisë me synim t'i adresojnë kërkesat e shoqërisë dhe t'i artikulojnë ato para institucioneve. Më pastaj janë zhvilluar në mobilizimin e qytetarëve për të marrë pjesë më aktivisht në jetën publike dhe rekrutimin e tyre për të garuar për poste në institucione. Por, deri në këtë fazë, ato kanë funksionuar si asociacione private. Më pas, kjo formë e organizimit është avancuar në organizim të kandidatëve, i cili ka pushuar ekzistencën me certifikimin e rezultateve zgjedhore. Sot, partitë politike janë institucione. Institucioni përfshinë jo vetëm organizimin formal, por edhe rregullat dhe procedurat jo formale të sjelljes.[2]

Partitë janë institucione që:

(a) kërkojnë të përfaqësojnë më shumë se vetëm një interes apo interesa të ngushta të shoqërisë dhe deri në një masë provojnë t'i "agregojnë këto interesa", dhe

(b) kërkojnë të ndikojnë në shtet, shpeshherë duke provuar të marrin pozita në qeveri.[3]

Partitë politike qëllim kryesor kanë përkrahjen e qytetarëve për ta fituar pushtetin. Partitë të cilat e fitojnë pushtetin përcaktojnë edhe përmbajtjen e politikave publike.

III. Çka është Ligji për Partitë Politike

Në shumë shtete, legjislacioni i përcakton kushtet mbi bazën e të cilave duhet funksionuar partitë politike. Mënyra se si janë hartuar ligjet zgjedhore në masë të madhe i përcakton kushtet bazike për veprimin e partive.[4]

Disa shtete i njohin partitë në kushtetutat e tyre, në disa të tjera ekziston ligj i veçantë që rregullon në mënyrë të detajuar funksionimin e partive politike që njihet si Ligji për Partitë Politike. Shtete të tjera demokratike kanë miratuar legjislacion që ka të bëjë me financimin e partive nga buxheti i shtetit. Kurse disa sosh,

aspektin e rregullimit ligjor të partive politike e kanë të përfshirë në kuadër të ligjeve të përafërta me këtë fushë. Sa për ilustrim, Guatemala ka ligj për "Partitë politike dhe zgjedhjet", Kolumbia ligjin për "Partitë dhe lëvizjet politike", dhe Britania e Madhe së voni (2000) "Ligjin për Partitë Politike, Zgjedhjet dhe Referendumet".

Nga një studim më i thellë që Lauri Karvonen i ka bërë këtyre ligjeve, ka konstatuar se përmbajtja dhe struktura e tyre është shumë e ngjashme me ato që "ekskluzivisht" janë ligje për partitë politike.[5] Ato definojnë partitë si subjekte ligjore dhe rregullojnë detyrat dhe aktivitetet e tyre.

Përkufizimi "Ligj për parti politike", ka kuptime të ndryshme për persona të ndryshëm, madje edhe në mesin e shkollarëve të partive politike. Ky përkufizim nganjëherë përdoret për t'iu referuar rregullave të brendshme, si dokumentet e partive dhe statutet e tyre, nëpërmjet të cilave partitë qeverisin veten. "Ligji për Partitë Politike", gjithashtu i referohet ligjeve shtetërore në lidhje me atë se çfarë mund apo nuk mund të bëjnë partitë – çfarë është legale dhe jo legale në politikat partiake. Përgjithësisht, kjo përfshinë ligjet në lidhje me atë se çfarë e përbën një parti politike, format e aktiviteteve në të cilat partitë mund të përfshihen, si dhe çfarë forma të organizimit dhe sjelljeve janë të përshtatshme.

Richard Katz, ka shkoqitur dallimet në mes të rregullave të brendshme të partive dhe rregullimit të jashtëm nga shteti dhe në këtë plan përmend tri objektiva të ligjit shtetërorë në lidhje me partitë politike:

1. *Përcaktimin se çka e përbën një parti politike.* Kjo zakonisht përcakton se kush kualifikohet për fletëvotim, kush përfiton prej resurseve publike (si subvencionet ose transmetimet në media), dhe kush merr pjesë në qeveri.
2. *Rregullimin e formës së aktiviteteve në të cilat partitë mund të përfshihen.* Kjo mbulon mbledhjen dhe shpenzimet e

fondeve, aktivitetet e fushatës dhe çështjet e përfshira në platformat partiake apo manifestet.

3. *Siguron format e përshtatshme të organizimit të partive dhe sjelljeve të tyre*. Kjo është një nga objektivat më të diskutueshme të Katz-it, sepse ndërhynë në çështjet e brendshme të lidershipit të partisë dhe të marrëdhënieve shoqërore. Ligjet mund t'u kërkojnë partive për të zgjedhur zyrtarë nga anëtarët e partisë, por një parti mund të preferojë të zgjedh lidershipin me anë të kongresit. Ligjet mund të kërkojnë barazi gjinore apo etnike, por edhe shtrirjen e partisë në rajone të ndryshme të vendit. Dikush mund të imagjinoj qëllimin e politikave, të cilat vendet kërkojnë t`i aplikojnë nëpërmjet ligjit të partisë.[6]

Ligji për Partitë Politike mund të definohet me një emër të përbashkët si rregullim i shtetit që përcakton statusin ligjor të partive politike dhe specifikon rolin e anëtarësisë në qeverisjen e partive, si duhet të organizohen partitë, si duhet të bëhen fushatat dhe si duhet të mbahen fondet.

Kufijtë e ligjit për partitë politike mund të caktohen duke marrë për bazë tri ligje të tjera: Ligji për Zgjedhjet, Ligji për Fushatat dhe Ligji për Financimin e Partive Politike.

Dallimi në mes të Ligjit për Partitë Politike, Ligjit për Zgjedhjet, Ligjit për Fushatat dhe atij për Financimin e Partive Politike

Si shtesë e Ligjit për Partitë Politike, disa vende – si Koreja e Jugut – kanë miratuar ligje të veçanta për administrimin e zgjedhjeve, fushatave dhe për financimin e partive politike. Secili nga këto ligje mbulon diçka nga ligji për partitë politike por fokusohet në diçka tjetër si më thelbësore.

Ligji për zgjedhjet: fokusin kryesor e ka në kornizën e administrimit të zgjedhjeve, që përfshijnë hedhjen e fletëvotimeve, certifikimin e partive, si dhe të drejtën e kandidatëve për t'u

zgjedhur. Ky, pra është një proces kompleks që kërkon rregullimin e sjelljeve të akterëve politik. Duke pasur parasysh që Ligji për Zgjedhjet shpesh specifikon se si duhet të funksionojnë partitë politike, teksa Ligji për Partitë Politike rrallë herë e specifikon se si duhet të funksionojnë zgjedhjet. Ka më shumë të ngjarë që disa vende më parë ta emërtojnë Ligji për Zgjedhjet, por jo Ligji për Partitë Politike. Nëse i kanë të dyja, ligji i tyre për Zgjedhjet ka tendencë për të qenë më voluminoz, duke përfshirë rregullat për partitë dhe zgjedhjet.[7]

Ligji për fushatat: duhet ta specifikoj kohëzgjatjen e fushatës zgjedhore, cilat aktivitete janë të lejuara, sa kohë para ditës së zgjedhjeve mund të publikohen anketat, si dhe aspekte të tjera të fushatës zgjedhore.

Ligji për financimin e partive politike: Karl-Heinz Nassmacher e përdorë termin "financa politike", për të përfshirë të dy ligjet,atë për "financimin e partive" dhe për "fushatat zgjedhore"[8]. Ligji për Financimin e Partive Politike specifikon burimet e lejueshme për financimin e partive politike, cakton kufirin e sipërm të donacioneve nga personat juridik dhe fizik, rregullat për mbajtjen e kontabilitetit, auditimin e partive, sanksionet dhe detyrime të tjera.

IV. PRAKTIKAT NDËRKOMBËTARE PËR LIGJIN PËR PARTITË POLITIKE

Gjatë dekadës së fundit janë zhvilluar një numër i madh i studimeve dhe projekteve të ndryshme lidhur me legjislacionin për partitë politike. Disa prej studiuesve kanë krijuar baza të të dhënave për vendet, të cilat kanë adoptuar ligje për partitë politike. Dy nga bazat më të hershme të të dhënave janë ajo e studiuesit danez (Lauri Karvonene, 2005) dhe atij amerikan (Kennth Janda, 2005). Projekti më ambicioz për legjislacionin e partive politike në Evropë është ai i Universitetit "Leiden" me titull "Ligji i Partive në Evropën Moderne", i cili shkoqit aspektin teorik dhe empirik të rregullimit

ligjor të partive politike në Evropën e pasluftës.[9] Kjo bazë e të dhënave, po ashtu mbulon aspektin kushtetues të Ligjit për Partitë Politike, si dhe Ligjit për Financimin e Partive Politike që nga viti 1944 deri më 2013.

Bazuar në hulumtimet tona dhe analizimin e bazës së të dhënave në dispozicion për partitë politike, deri më sot janë identifikuar 57 vende, të cilat kanë ligje për partitë politike (Tabela 1). Disa prej vendeve rregullimin ligjor të partive politike e bëjnë në kuadër të një ligji tjetër të përafërt (p.sh. Ligjit për Partitë Politike dhe Referendumet në Britani të Madhe). 24 shtete të Evropës dhe 10 të kontinentit amerikan kanë ligje për partitë politike. Pesëmbëdhjetë shtete të Afrikës, shtatë të Azisë dhe një shtet i Oqeanisë, po ashtu kanë ligje për partitë politike. Shumica dërmuese e ligjeve ekzistuese për partitë politike janë hartuar pas përfundimit të Luftës së Ftohtë.

Partitë politike kanë filluar të njihen në praktikë, jo domosdoshmërish me rregullat formale, në parlamente, në fillim të shekullit të XIX.

Njohja e parë zyrtare e partive në Dhomën e Përfaqësuesve në Mbretërinë e Bashkuar nuk ka ndodhur deri në 1909.[10] Ligjet e veçanta për parti politike janë dizajnuar për të rregulluar sferën e organizimit të brendshëm partiak dhe janë miratuar në ShBA gjatë Epokës Progresive (ndërmjet viteve 1890 – 1930). Në kohën kur janë hartuar janë përfshirë brenda ligjit për zgjedhjet. Në Evropë këto ligje në mënyrë më të gjerë janë adaptuar ndërmjet viteve 1960-1970 (Gjermani 1967; Finlandë 1969; Austri 1975; Spanjë 1978; Portugali 1977), dhe më pastaj në vitet pas rënies së Murit të Berlinit (Bullgaria 1990; Republika Çeke 1991; Estonia 1994; Hungaria 1989; Lituania; 1990; Maqedonia dhe Polonia 1990; Romania 1996; Mbretëria e Bashkuar 2000 dhe Rusia 2001.) Në Amerikë Latine, ligjet më të hershme janë miratuar në Venezuelë (1965) dhe Argjentinë (1982).[11] Një përhapje më e shpejtë e ligjit për

partitë politike ka ndodhur në fund të shekullit XX dhe fillim të shekullit XXI.

Tabela 1: Vendet të cilat kanë Ligj për Partitë Politike, të ndara sipas kontinenteve

Evropa	**Amerika Latine**	**Azia**	**Afrika**	**Oqeania**
Austria	Argjentina	Izraeli	Somalilandi	PapuaGuinea e Re
Finlanda	Venezuela	Jordania	Kamboxhia	
Gjermania	Guatemala	Jemeni	Algjeria	
Polonia	Uruguai	Armenia	Sudani	
Spanja	Bolivia	Burma	Gana	
Bullgaria	Ekuadori	Rusia	Mali	
Hungaria	Kili	Turqia	SaoTome dhe Pr.	
Romania	Hondurasi	Tailanda	Angola	
Portugalia	Kolumbia	Indonezia	Egjipti	
Mbretëria e Bashkuar	Brazili	Koreja Jugore		
Republika Çeke		Tajvani		
Estonia		Nepali		
Lituania		Kazakistani		
Maqedonia				
Moldavia				
Kroacia				
Qipro				
Letonia				
Norvegjia				
Serbia				
Sllovakia				
Sllovenia				
Ukraina				
Shqipëria				

Burimi: Baza e të dhënave e krijuar nga Dr. Kenneth Janda, dhe hulumtimet e autorit.

V. MODELET E LIGJIT PËR PARTITË POLITIKE

Profesori i shkencave politike në *Northwestern University*, Kenneth Janda, ka identifikuar pesë modele të ndryshme të rregullimit të partive në shtete të ndryshme: politika që ndalojnë, lejojnë, promovojnë, mbrojnë ose përshkruajnë veprimtarinë e partive politike[12]. Shtetet tentojnë t`i ndjekin këto modele, por ligjet specifike mund t'u përshtaten rregullave të ndryshme të politikave, që reflektojnë kompleksitetin e procesit të ligjbërjes. Në përgjithësi, vendet që e ndalojnë funksionimin e partive me ligj, i privojnë ato të veprojnë lirshëm; vendet që e lejojnë funksionimin e partive, u mundësojnë atyre të veprojnë lirshëm; vendet që i promovojnë partitë aktivisht, i mbështesin ato; vendet që i mbrojnë partitë, favorizojnë parti të caktuara mbi të tjerat; vendet që përshkruajnë partitë kërkojnë që ato t'i përshtaten një ideali.

Vlerësimi i ligjeve të partive politike duhet të bëhet mbi parimin e lehtësimit apo pengimit të politikës partiake. Plasser dhe Plasser në studimin e tyre të vitit 2002 për "fushatat politike globale", vlerësuan ligjet e fushatave politike. Për të vendosur pak rend në rregullat që mblodhën në 52 shtete, ata klasifikuan vendet sipas praktikave të fushatës nëse ishin "të rregulluara me rigorozitet", "të rregulluara në mënyrë të moderuar" ose "minimalisht të rregulluara".[13]

Modeli ndalues/dëbues

Të ndaloj, do të thotë të deklaroj diçka si të paligjshme apo ta dëbojë. Megjithatë, përkufizimet "të paligjshëm", ose "dëbuar", nuk janë përdorur në asnjë prej ligjeve të partive politike.

Në vende të caktuara, tendenca për ndalim të partive politike bëhet nëpërmjet mohimit të statusit të tyre ligjor. Kjo konkretizohet me mos përfshirjen e tyre në aktin më të lartë shtetëror - Kushtetutë. Megjithatë, mos përfshirja në këtë dokument nuk është tregues i sigurt i modelit ndalues/dëbues.

Modeli lejues

Modeli lejues i ligjit të partive u jep mundësi atyre të ekzistojnë dhe veprojnë pa specifikuar se si duhet të bëhet anëtarësimi në parti politike, si duhet të organizohen partitë, si duhet t'i zgjedhin liderët e tyre dhe si duhet t'i financojnë aktivitetet e tyre. Ky është modeli minimalist i rregullimit. Janda, në studimin i tij për partitë politike thotë se me gjasë asnjë vend nuk është tërësisht lejues ndaj partive politike, por e praktikojnë modelin minimal, siç vërehet në kushtetutën e Andorrës. Edhe në këtë rast, lejimi i partive politike në Andorrë, kufizohet me kërkesën për demokraci të brendshme partiake.

Modeli promovues

Vendet ndonjëherë miratojnë ligje që promovojnë jo vetëm aktivitetet e partive politike, por edhe krijimin e tyre. Në mënyrë tipike ato e bëjnë këtë përmes legjislacionit të zgjedhjeve që favorizon krijimin ose vazhdimësinë e shumë partive politike. Një prej këtyre mënyrave mund të jetë përcaktimi për sistemin zgjedhor proporcional me zona shumë anëtarësh që prodhojnë numër më të madh të partive. Mirëpo, disa studiues argumentojnë se sistemi proporcional i përfaqësimit nuk krijon shumë parti por mbron ekzistencën e partive ekzistuese.

Një formë tjetër e promovimit të partive është përmes dhënies së subvencioneve publike. Richard Katz dhe Peter Mair kanë argumentuar se partitë politike në shumë vende kanë arritur të nxjerrin fonde nga shteti për ta mbështetur veten. Në shtetet në të cilat rregullat ligjore nxirren prej partive politike, bëhen burim i resurseve përmes të cilave këto parti jo vetëm ndihmojnë për të siguruar mbijetesën e tyre, por edhe për t'i rritur kapacitetet e tyre për t`i rezistuar sfidave nga mobilizimi i alternativave të reja.[14]

Modeli mbrojtës

Modeli mbrojtës është më ekstremi i mundshëm për çdo parti politike, ngase me të lejohet funksionimi i vetëm një partie, siç ka bërë Siria me partinë Ba'th.[1] Në disa vende në zhvillim, liderët e partive e kanë strukturuar kornizën ligjore në mënyrë që të rrisin disiplinën ligjore brenda anëtarëve të partive të tyre në parlament. Disa vende kanë adaptuar dispozita kushtetuese që u shkaktojnë anëtarëve të parlamentit humbjen e mandatit nëse ata e "kalojnë kufirin", respektivisht kalojnë në parti të tjera. Një legjislacion i tillë u jep shumë fuqi liderëve të partive.

Modeli përshkrues

Të përshkruash, do të thotë të japësh urdhër, të diktosh. Mjeku përshkruan ilaçet për të shëruar sëmundjen; qeveritë shtetërore bëjnë ligjin për partitë politike për të kuruar atë që mendojnë se është gabim në funksionimin e partive politike. Forma ekstreme e modelit përshkrues të rregullimit të partive politike iu mundëson regjimeve të kontrollojnë organizimin e partive politike dhe sjelljet e tyre. Kushtetuta e Portugalisë është më e detajuar në përshkrimin e organizimit të partive politike. Ajo jo vetëm që kërkon nga partitë të demonstrojnë "organizim dhe menaxhim demokratik", por sanksionon edhe emërtimin dhe përdorimin e simboleve të partisë.[2] Edhe kushtetuta e Gjermanisë dhe Spanjës kërkon nga partitë politike të veprojnë sipas parimeve "demokratike". Ligji për Partitë Politike në demokracitë e zhvilluara dhe atyre në tranzicion, dallon shumë sa i përket asaj se kur janë krijuar dhe nga kush. Ligji i Gjermanisë për Partitë Politike është miratuar pas 35 vjetëve të përvojës me politikat partiake, me përfshirjen e fuqishme të partive

---

[1] Kushtetuta e Sirisë, Neni 8 thotë se "Partia e vetme udhëheqëse e shoqërisë dhe shtetit duhet të jetë partia socialiste Ba'th."

[2]Kushtetuta e Portugalisë, Neni 52 "Pa paragjykime për filozofinë apo ideologjinë që ndodhen në programet e tyre, partitë politike nuk mund të përdorin emra që përmbajnë shprehje drejtpërdrejt të lidhura me religjion ose kishë, ose të përdorin simbole që mund të ngatërrohen për simbole shtetërore apo religjioze."

politike. Megjithëse ligji i Gjermanisë rregullon praktikat e partive, ai në mënyrë efektive njeh praktikat e krijuara të partive konkurruese.

VI. ÇKA DUHET TË PËRMBAJË LIGJI PËR PARTITË POLITIKE

Mënyra më direkte për të përmirësuar demokracinë në një vend është përmes përmirësimit të qeverisjes së brendshme të institucioneve. Kjo përfshinë edhe partitë politike, pasi që ato janë pjesë përbërëse e institucioneve, teksa brenda një periudhe të shkurtër kohore kjo gjë mund të bëhet nëpërmjet legjislacionit. Numri i vendeve që kanë ligje të veçanta për parti politike është në rritje. Mungesa e një ligji që përkufizohet me titullin "Ligji për Parti Politike", nuk nënkupton mos rregullimin e partive politike me ligj. Për më tepër, edhe kur ka një ligj të tillë asnjëherë ai ligj nuk i përmban të gjitha dispozitat përkatëse për partitë. Në veçanti ato shpërndahen në dispozita kushtetuese, ligjin për zgjedhjet, ligjin për financimin e partive politike dhe atë për fushatat zgjedhore, por edhe në rregullat e procedurës së parlamenteve. Të gjitha këto përbëjnë kornizën ligjore brenda së cilës operojnë partitë politike.

Definicioni ligjor dhe statusi i partive politike

Elementi më bazik i çdo ligji për partitë politike është përcaktimi i definicionit të "partisë politike". Në njërën anë, ato qartësisht apo nënkuptueshëm identifikojnë natyrën e përgjithshme të partive – si dallon partia prej llojeve të tjera të organizimeve. Nga ana tjetër, ato vendosin kritere që duhet përmbushur nga ndonjë formë e organizimit të veçantë që të mund të njihen ligjërisht si parti

politike, të marrin përfitime nga shteti, apo që të jenë subjekt i kërkesave/kufizimeve të jashtëzakonshme.[3]

Dy indikatorët më kryesor të dimensionit privat/publik janë: shkalla që i përcaktohet partive si funksion prej ligjit që në mënyrë të qartë është e njohur si publike, dhe shkalla në të cilën rregullimet e brendshme të partive janë subjekt i rregullimit të detajuar ligjor, ngjashëm me ato institucione që janë plotësisht institucione publike. Në lidhje me të parën, për shembull, Kushtetuta e Gjermanisë (Neni 21), u cakton partive detyra të "pjesëmarrjes në formimin e vullnetit politik të popullit",[4] përderisa Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë ka njohur partitë si "institucione të së drejtës kushtetuese".

Ligji për partitë politike i Gjermanisë shkon më tutje duke ju caktuar partive funksionin:

> *frymëzimin dhe avancimin e edukimit politik; promovimin e pjesëmarrjes aktive publike në jetën politike; trajnimi dhe aftësimi i personave për të marrë përgjegjësi publike; pjesëmarrja në zgjedhjet për qeverisjen federale, të landeve dhe lokale duke nominuar kandidatët, ushtrimin e ndikimit në zhvillimet politike në parlament dhe qeveri; përfshirjen e qëllimeve të tyre politike në proceset vendimmarrëse nacionale;dhe sigurimin e vazhdimësisë së lidhjeve vitale ndërmjet qytetarëve dhe instrumenteve të shtetit (neni 1.2)*

Duke i renditur këto funksione, ligji nuk njeh thjeshtë vetëm rëndësinë e asaj se çfarë bëjnë partitë, por edhe i identifikon ato me funksione publike. Megjithëse retorika e organizimit privat të partive mbetet e dukshme, trendët janë në drejtim të variantit që

---

[3]Siç është rasti në Kanada që nëse numri i anëtarëve të një partie politike bie nën 250 apo dështon të nominojë kandidatë për zgjedhje, atëherë humbet statusi ligjor i partisë së regjistruar.

[4]Ngjashëm, Kushtetua e Australisë përcakton: "Një nga funksionet kryesore të partive politike është të marr pjesë në formimin e vendimeve politike".

Epstein dhe vanBiezen e identifikojnë si model të "shërbimit publik", në të cilin partitë njihen si performues esencial të funksioneve publike dhe prandaj ju akordohet status special dhe privilegje në shkëmbim të rritjes së nivelit të rregullimit ligjor.[15]

Regjistrimi dhe Statuti

Një nga teoricienët më të njohur të partive politike, Richard Katz, i definon statutet e partive "si një tërësi të rregullave të nxjerra nga secila parti për qeverisjen e saj të brendshme". Problemi më i veçantë për legjislacionin e partive politike është që të përcaktojë kriteret dhe procedurat që një organizatë duhet t`i plotësoj në mënyrë që të njihet si parti, e sidomos të njihen si parti me të drejtën për të pasur qasje në përfitimet nga institucionet publike. Edhe pse kombinimet specifike të kërkesave ndryshojnë jashtëzakonisht shumë, shumica mund të ndahen përafërsisht në tri kategori të përgjithshme: rregullimin organizativ; madhësinë dhe seriozitetin; si dhe përkushtimin demokratik.[5]

Organizimi i brendshëm

Në emër të rritjes së demokracisë, partive mund t`u kërkohet të ndërmarrin masa të veçanta për të promovuar përfshirjen e grave apo të grupeve të tjera tradicionalisht të margjinalizuar në strukturat e tyre. Kjo mund të bëhet me imponimin e kuotave ligjore në listat e kandidatëve të partive për të siguruar barazi më të madhe gjinore. Për shembull Ligji për Partitë Politike në Indonezi (Ligji 2/2008), vendos detyrimin për të gjitha partitë për të zbatuar kuotën prej 30% për gratë në strukturat vendimmarrëse të partisë. Në raste më të shpeshta, partitë sanksionohen me ligj kundër diskriminimit të kandidatëve në bazë të gjinisë apo racës.[6]

---

[5]Përveç kësaj, shumë sisteme imponojnë një seri të kërkesave teknike, si emri i partisë të mos të ngatërrohet lehtësisht me emrin e një partie ekzistuese ose që simboli i saj të mos përmbajë ikonografi kombëtare ose fetare.

[6]Për shembull, në vitin 2010 Gjykata Supreme e Holandësvendosi që shteti është i obliguar me Konventën e OKB-së të vitit 1979 për Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj

Në të njëjtën mënyrë, partive mund t`u ndalohet me ligj diskriminimi në bazë të kritereve të anëtarësimit.

Diskriminimi mbi bazë ideologjike, duket i pakuptimtë, ngase në përgjithësi partitë janë grupime të njerëzve që ndajnë një perspektivë të përbashkët politike. Megjithatë ndalimi i diskriminimit për shkak të gjinisë ose etnisë është prezent në disa vende. Kjo ka të bëjë veçanërisht me përkatësinë etnike, ku ndalimi mund të jetë kundër diskriminimit negativ (përjashtimi nga anëtarësia partiake) apo kundër diskriminimit pozitiv (formimi i partive një etnike).[16]

Përzgjedhja e kandidatëve

Karakteristika kryesore që i dallon partitë politike prej organizimeve të tjera politike është paraqitja e kandidatëve në zgjedhje. Ka shumë mënyra se si partitë i nominojnë kandidatët e tyre. Ata mund të zgjidhen nga një lider i vetëm ose në konsultim me disa këshilltarë, por ka edhe raste kur kandidatët zgjedhën nga votuesit që nuk janë anëtarë të partisë.[17]

Sot në shumë sisteme është duke u zhvilluar një trend që e rritë në njëfarë mënyre fushën e "përzgjedhësve" të kandidatëve me anë të zgjedhjeve të brendshme (ang. *primaries*). Mirëpo, kjo formë e zgjedhjes duhet të ketë parasysh disa çështje.

1. Nëse këto të ashtuquajtura '*primaries*' janë zgjedhje publike që menaxhohen nga zyrtarët publik me ligj publik(ang. *publiclaw*) siç ndodhë në SHBA apo në Argjentinë, ose nëse janë zgjedhje të brendshme partiake që menaxhohen nga zyrtarët e partisë në përputhje me rregullat e përcaktuara nga secila parti për nevoja të veta.

---

grave (CEDAWË) për të ndërmarrë masa efektive për të shtyrë Partinë Politike Reformatore (SGP – StaatkundigGereformeerdePartij), t`i pranoj gratë si kandidate pa imponuar ndonjë kuotë numerike.

2. Çështja e të drejtës së votës. Për zgjedhjet që i organizon vet partia është e pritshme që të drejtë vote të kenë vetëm anëtarët e partisë. Por, është një numër gjithmonë në rritje të partive që i lejojnë edhe mbështetësit të votojnë (mbështetës që kanë dhënë ndonjë kontribut të vogël në formën e një tarife për të votuar e që në zgjedhjet publike njihet si 'taksë votimi').
3. Deri në çfarë mase rezultatet e këtyre zgjedhjeve merren parasysh nga strukturat kryesore të partisë. Në Danimarkë për shembull deri në fillim të shek. XXI udhëheqja qendrore e partisë ka pasur të drejtë të përdorë veton për vendimin që kanë marrë anëtarët e partisë ndërsa në Finlandë ligji e lejon udhëheqjen qendrore të partisë të ndryshojë deri në ¼ e kandidatëve të zgjedhur nga anëtarët.[18]

Kjo formë e zgjedhjes së përfaqësuesve mund të vlerësohet nga dy aspekte. Nga njëra anë, votim i drejtpërdrejtë i anëtarëve mund ta rritë kontrollin e udhëheqjes qendrore duke e bërë më të vështirë koordinimin mes nivelit të mesëm të aktivistëve të partisë dhe në këtë mënyrë ta përmbys votimin me "mbështetës" të partisë që i nënshtrohen më lehtë vendimeve të strukturave të partisë.[19]

Dimensioni tjetër lidhet me justifikimin e pretenduar për zgjedhjet e brendshme (zgjedhja e kandidatëve më të mirë), ndaj kritereve që pritet t'i përdorin votuesit kur e hedhin votën. Pritjet e përgjithshme janë që përzgjedhësit që janë të përbërë nga udhëheqësit e partisë kanë prioritet të zgjedhin si 'fitues' kandidatët që do të mund t'ia rrisin atraktivitetin partisë në zgjedhjet e përgjithshme. Me këto zgjedhje e sidomos me votim të fshehtë ndodhë e kundërta, sepse votuesit në këtë rast zgjedhin kandidatët që ata/ato personalisht duan ta shohin të zgjedhur, në vend të atyre që kanë mundësinë më të mirë që të zgjedhën.[20]

Zgjedhjet e brendshme si mënyrë e zgjedhjes së kandidatëve bien ndesh me rregulloret e hartuara për rritje të llojllojshmërisë brenda partisë. Kjo për shkak se në këtë lloj të zgjedhjes së kandidatëve

mund të zgjedhin kandidatët që janë të preferuarit e atyre që i votojnë prandaj edhe shihet si nevojë përdorimi i kuotës gjinore.

Financimi i partive politike

Financimi i partive politike është një prej çështjeve kyçe që rregullon Ligji për Partitë Politike. Një grup i qartë i rregullave të financave janë ato që i kufizojnë edhe kategoritë ku përfshihen individët ose subjektet të cilët janë të lejuara të bëjnë shpenzime/kontribute politike ose prej të cilave partitë ose kandidatët janë të lejuara të marrin kontribute, ose kufizimi i masës së lejuar të kontributeve nga çfarëdo burimi.[21]

Është e diskutueshme nëse këto rregulla të financimit të partive politike duhet të aplikohen vetëm gjatë fushatave zgjedhore apo në të gjitha aktivitetet e partive. Sa i përket fushatave zgjedhore, është e rëndësishme të dihet nëse financimi për kandidatët dhe partitë është i rregulluar me ligj. Nëse janë të rregulluara, duhet të precizohet nëse veprojnë si grup ose të ndarë. Ndërsa sa i përket aktiviteteve të partisë, çështja është nëse rregullimi aplikohet vetëm në aktivitetet e drejtuar nga jashtë (si për shembull propaganda ndër – zgjedhore) ose edhe në funksionet e brendshme të partisë.[22]

Një grup tjetër i rregullave të financave ka të bëj me raportimin. Publikimi (dhe auditimi i besueshëm) i shpalosjes së financave ka dy qëllime. E para është për ta lehtësuar zbatimin e rregulloreve të financave. Kjo kërkon auditim të besueshëm, i cili duke marrë parasysh shpenzimet dhe kohën e përfshirë, mund të zhvillohet në mënyrë të arsyeshme vetëm në fund të rrethit zgjedhor ose vitit financiar. Te parregullsitë e mundshme që kanë të bëjnë me financat zgjedhor është e diskutueshme se çka duhet të ndërmerret në qoftë se parregullsitë janë zbuluar vetëm pas përfundimit të zgjedhjeve. Qëllimi tjetër i raportimit financiar është t`i informojë votuesit në mënyrë që edhe nëse nuk eliminohet ndikimi i parave, të paktën ta dinë paraprakisht kush kujt i është mirënjohës. Raportet që janë botuar vetëm disa javë apo muaj pas zgjedhjeve si dhe ato të

bëra publike para votimit, në mënyrë të qartë nuk mund t'i shërbejnë këtij qëllimi; rezultati i vetëm që mund të arrihet është parashtrimi i një kërkese që të zbulohen më herët raportet e paaudituara ose të përkohshme. [23]

Kuptohet se funksionimi i një partie politike në botën demokratike është i kushtueshëm, prandaj për të kufizuar varësinë e partive politike ndaj donatorëve dhe mbështetësve privat është krijuar një mënyrë tjetër e mbështetjes përmes subvencionimit shtetëror. Kjo formë e mbështetjes financiare mund të bëhet në disa mënyra, qoftë nëpërmjet qasjes së lirë në masmedia, ndihmë në shpenzimet për taksa, nëpërmjet kredive tatimore, zbritjeve nga kontributet politike, dhënia e granteve etj.

Organizimi dhe sjelljet në parlament

Deputetët janë të lirë ta ndërrojnë partinë gjatë një mandati parlamentar, mirëpo ky fenomen është i rrallë për shumicën e demokracive të konsoliduara. Edhe në rast se ndodh nuk ka sanksione për të. Ndërrimi i partisë i shkakton dy probleme të mëdha: së pari e minon stabilitetin e qeverisë dhe së dyti e parandalon progresin e partive përtej interesave të grupeve brenda partive.

Në një numër të konsiderueshëm të rasteve, ka pasur veprime legjislative për të respektuar (zbatuar) stabilitetin e partisë. Për shembull, 14% e demokracive të vjetra (India, Izraeli, Portugalia etj.), 24 % e demokracive të reja, dhe 33% e gjysmë-demokracive kanë ligje kundër dezertimit të partive (grupeve) parlamentare.[24]

Edhe pse sipas normave ndërkombëtare dhe disa prej kushtetutave mandati i një deputeti është i pavarur nga partia e tij pasi që ai të jetë zgjedhur si i tillë. Mirëpo, shumë organizata ndërkombëtare janë pajtuar me kundërshtimin për ndërrim të partisë, duke pohuar se kjo praktikë është më shumë një simptomë e korrupsionit sesa që ka të bëj me parimet.[25]

Zbatimi i rregullave dhe zgjidhja e kontesteve

Shteti mund të përfshihet në funksionimin e partive politike nëpërmjet dy rrugëve. Në njërën anë, nëse rregullat/obligimet ligjore që janë të vendosura në vend janë të efektshme, aty duhet të ketë procedura për zbatim, duke përfshirë hetimin e shkeljes së dyshuar dhe vlerësimin e dënimeve, nëse konstatohet se janë të përshtatshme në ato rrethana. Nga ana tjetër, në shoqëritë gjithnjë kontestuese, mundësia që gjykatat të thirren për të gjykuar kontestet e brendshme – t`i interpretojnë rregullat e brendshme të partisë, ose të paktën respektimin e rregullave nga vet partia - ose kontestet midis partive janë gjithmonë në rritje.[26]

Partitë mund të kenë mundësi të kenë mekanizmat e vetë për zgjidhjen e kontesteve, ato mund t'i drejtohen gjykatave të shtetit në lidhje me kontestet e brendshme partiake vetëm pasi të janë shterur të gjitha mjetet e brendshme dhe vetëm në lidhje me çështjet për të cilat janë respektuar procedurat e vet partisë.

Në disa raste, organi i menaxhimit zgjedhor mund të hetojë vetëm akuzat e sjella para saj nga palët e dëmtuara; në raste të tjera ajo mund të iniciojë hetime me iniciativë të vet. Nëse janë gjetur shkelje, organi i menaxhimit zgjedhor mund të ketë autoritetin për vlerësimin e dënimeve (zakonisht, por jo gjithmonë, subjekt për të apeluar në gjykata); në raste të tjera ajo vetëm mund të fillojë ose të rekomandojë fillimin e ndjekjes penale, në gjykata.[27]

Standardi i qartë ndërkombëtar është që rregullat duhet të zbatohen në mënyrë të paanshme, dhe nga një organ i paanshëm, me një prirje të fortë në favor të përdorimit të organeve të pavarura - në mënyrë që të shmangen rreziqet e zbatimit vetëm kundër kundërshtarëve të qeverisë aktuale, ose të një lloj pakti për mbrojtjen e ndërsjellë në mes të partive të mëdha - dhe për detyrime gjyqësore, ose të paktën shqyrtim gjyqësor për të gjithë, por sanksione më të vogla.

Edhe përdorimi i sanksioneve bëhet në proporcion me shkeljet që janë bërë sipas dy standardeve ndërkombëtare. I pari ka të bëjë me dënimin për shkelje, i cili duhet të jetë në proporcion me seriozitetin e veprës. Për shembull shkeljet teknike apo të vogla nuk duhet të çojnë në shpërbërjen e partisë - sepse shpërbërja ose çregjistrimi duhet të jetë e rezervuar për vepra më të rënda. Standardi i dytë i rëndësishëm është që partia si një bashkësi nuk duhet të konsiderohet përgjegjëse për veprimet e paautorizuara të një apo më shumë anëtarëve të saj.[28]

Sanksionet dhe ndalesat ndaj partive politike

Ligji për Partitë Politike i Spanjës, i miratuar në vitin 1978 dhe rishikuar në vitin 2002, përmban dispozita të detajuara që kanë për qëllim të ndalojnë bashkëpunimin ndërmjet partive politike dhe organizatave terroriste (Neni 9). Ky ligj në mënyrë të qartë ndalon lidhjet me organizatat terroriste dhe përdorimin e simboleve të caktuara që lidhen me terrorizimin. Paragrafi 33 i Ligjit gjerman për Partitë Politike ndalon partitë të krijojnë trupa që funksionojnë si zëvendësim për partitë që kanë qenë të ndaluara si antikushtetuese. Në terma konkret, objekt janë partitë Neo-Naziste dhe Komuniste që janë shpallur si antikushtetuese nga Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë në vitin 1952 dhe 1956[29]. Ligji për Partitë Politike i Portugalisë ndalon përdorimin e emrave të individëve ose të simboleve religjioze apo nacionale në etiketat ose emblemat e tyre (Neni 5). Për më tepër, neni 19 i këtij ligji, në mënyrë të qartë ndalon betimin për lojalitet ndaj lidershipit të partisë. Fakti që në ligjin e Portugalisë është zgjedhur që të ndalohen këto forma të kultit të personalitetit është i kuptueshëm në relacion me kohëzgjatjen e diktaturës (1933-1974),të Oliveira Salazar.[30]

Ligji Algjerian ndalon partitë të bazuara në sektarizëm, rajonizim, feudalizëm apo nepotizëm, si dhe partitë që vënë në pyetje "vlerat e moralit islamik ose identitetit kombëtar" (Neni 5). Ato obligohen të përdorin vetëm gjuhën zyrtare kombëtare në aktivitetet e tyre (Neni 4).

Nga studimi i Karvonen "Legjislacioni për partitë politike: Një krahasim global", janë identifikuar sanksione dhe ndalesa për partitë politike në vendet që janë demokraci të reja e që sot në mënyrë rigoroze përmbushin kriteret e të drejtave politike dhe lirive civile.[31] Këto raste janë në vendet që karakterizohen me heterogjeniteti etnik dhe kulturor si: Bullgaria, Gana, Mali, Papua Guinea e Re, dhe Sao Tome dhe Principe. Kufizimet e përfshira në ligjet për partitë politike ndalojnë themelimin e partive në baza gjuhësore, religjioze, apo regjionale. Në shumicën e demokracive të reja anëtarësimi në parti është i papranueshëm për zyrtarët policor, anëtarët e forcave të sigurisë apo ushtarake, ose gjyqtarëve të gjykatës. Në shumë raste, përdorimi i emblemave kombëtare si simbole të partive është i ndaluar, siç është i ndaluar edhe themelimi i njësive paramilitare brenda partive. Shumica e shteteve gjysmë-demokratike dhe jo-demokratike kanë prezantuar kufizime në mënyrë që të mbajnë larg zyrtarët qeveritar nga politikat e partive politike dhe parandalojnë partitë nga organizimi i tyre ushtarak.[32]

Edhe vendet me demokraci të konsoliduar ofrojnë sanksione të konsiderueshme në ligjet e tyre për partitë politike. Ligji spanjoll përshkruan shpërndarjen e partisë me vendim gjyqësor nëse ka shkelur në mënyrë flagrante rregullat në lidhje me demokracinë e brendshme ose kanë bashkëpunuar me organizata terroriste (Neni 10). Sanksione të ashpra në forma të tjera përmbajnë ligjet e Izraelit, Spanjës dhe të Gjermanisë. Për shembull, mashtrimi serioz në mbajtjen e llogarive financiare të partisë mund të bëjë në maksimum dënimin me tre vjet burgim (Ligji Gjerman për Partitë Politike, paragrafi 31d). Manipulimi i fletëvotimeve të brendshme të partisë mund të rezultoi me një vit dënim me burg në Izrael.[33]

Përfundimi i përgjithshëm që Karvonen nxjerr nga studimi i tij është se shtete të ndryshme kanë ligje për partitë politike për qëllime të ndryshme. Në të paktën disa shtete jo-demokratike qëllimi kryesor i ligjit është që të parandalojnë lloje të caktuara të

mobilizimit politik. Frika në lidhje me fragmentimin e shtetit në baza etnike ose rajonale manifestohet në disa prej ligjeve. Në demokracitë e reja, shprehet një dëshirë e përgjithshme për të neutralizuar aktivitetet e partive që lidhen me regjimet e mëparshme jo demokratike.

VII. PËRFUNDIM

Rregullimi përmes ligjit të veçantë për regjistrimin dhe përcaktimin e kritereve minimale të funksionimit demokratik të partive politike është i rëndësisë së veçantë. Partitë politike konsiderohen institucione themelore në demokraci. Sa ma shumë që të konsultohet anëtarësia e partive politike për vendimet dhe orientimet programore të tyre, duke kaluar nga një lloj i qeverisjes nga poshtë-lartë dhe jo nga lartë-poshtë, aq më gjithëpërfshirëse dhe më të duhura do të jenë vendimet që partitë marrin. Kjo frymë e konsultimeve me anëtarësinë, do të bartej edhe tek institucionet kur partitë vijnë në pushtet, duke konsultuar publikun gjatë marrjes së vendimeve dhe hartimit të ligjeve.

Ligji duhet të parasheh edhe kriteret minimale që duhen zbatuar nga partitë në zgjedhjet e tyre të brendshme, si zgjedhjen e kryetarit dhe të strukturave të tjera udhëheqëse. Nominimi i kandidatëve në listat e partive politike, si për nivelin qendror ashtu edhe atë lokal duhet të përcaktohet me ligj. Duke e ditur paraprakisht rrugën e cila duhet të ndiqet për t'u përfshirë në listë, e bënë më të lehtë kandidimin për pretendentët, pasi përfshirja ose jo, nuk do të varej nga vullneti i liderit apo elitave partiake. Format e revanshit ndaj deputetëve që nuk kanë ndjekur në mënyrë rigoroze linjën e partisë, do të eliminoheshin.

Një prej çështjeve kryesore, që patjetër duhet ta përmbajë Ligji për Partitë Politike, është përcaktimi i mënyrës se si bëhet zgjedhja e kontesteve të brendshme, duke mos e lënë këtë në vullnetin e komisioneve statutore të partive, por duke e kaluar tek institucionet

e pavarura, siç është ai i gjyqësorit. Kjo do të ndikonte në demokratizimin e partive politike, do të zvogëlonte autokracinë dhe do t'i jepte fund qeverisjes së përjetshme të liderëve, pasi gara do të mund të hapej për kandidatët e tjerë.

VIII. REFERENCAT

[1]Warw, Alan, "*Political parties and party systems*", Oxford University Press, 1996.

[2]Kathleen Thalen and Sven Steinmo, "*Historical Institutionalism in Comparative Politics*", Cambridge: Cambridge University Press, 1993.

[3]Warw, Alan, "*Political parties and party systems*", Oxford University Press, 1996.

[4]Grofman, B. and A. Lijphart, eds., 1986. *Electoral Laws and Their Political Consequences*. New York: Agathon Press, Inc.

[5]LauriKarvonene, *"Legislation on Political Parties: A Global Comparison"*, paper presented at the Southwestern Political Science Association 2005 Annual Meeting, New Orelans, March 23-26: 4

[6]Kenneth Janda, "*Adopting Party Law"*, National Democratic Institute for International Affairs, Washington, D.C., 2005, 8.
[7] Ibid.

[8]Karl-Heinz Nassmacher, "Comparative Political Finance in Established Democracies" (Introduction), in Karl-Heinz Nassmacher, ed., *Foundations for Democracy: Approaches to Comparative Political Finance* (Baden-Baden: NomosVerlagsgellschaft, 2001), 10.

[9]Party Law in Modern Europe, http://www.partylaw.leidenuniv.nl/page/about-us

[10]Katz, Richard S. "*Reformimi i partive politike përmes rregullimit ligjor*", CEP and CEPLAN: 8

[11]Ibid. 9
[12]Kenneth Janda, "*Adopting Party Law"*, National Democratic Institute for International Affairs, Washington, D.C., 2005, 8.

[13]Fritz Plasser with GundaPlasser, "*Global Political Campaign"*, 151.

[14]Richard S. Katz and Peter Mair, "Changing Models of Party Organization and Party Democracy: The Emergence of the Cartel Party," *Party Politics* 1 (January 1995): 16.

[15]Ibid. 12

[16]Ibid. 16

[17]Ibid. 17

[18]Ibid.

[19]Ibid. 18

[20]Ibid. 19

[21]Ibid. 21

[22]Ibid. 23

[23]Ibid. 25

[24]Ibid. 30

[25]Ibid. 31

[26]Ibid. 31

[27]Ibid. 32

[28]Ibid.

[29]LauriKarvonene, *"Legislation on Political Parties: A Global Comparison"*, paper presented at the Southwestern Political Science Association 2005 Annual Meeting, New Orelans, March 23-26: 11

[30]Ibid.

[31] Ibid.

[32] Ibid.

[33]Avnon, D. 1996. "*Parties Laws in Democratic Systems of Government*", The Journal of Legislative Studies, Vol. 1, No. 2, Summer 1995: 296.